

pajtimi. Here ngadale e here shpejt, por mietet. Aktualisht janë me shume se 1600 familje te ngujuara, kryesisht ne veri te Shqiperise. Jane rreth 900 femijet viktime e ketij fenomeni.

Ne hapësiren e lene bosh nga ruajtësit e zbatimit te ligjit, xhungla e kodit mesjetar eshte pre e spekulimeve. "Vetëgjyjesine per marrjen e gjakut nuk mund ta quajme gjakmarrje" thote Gjijn Marku, kryetar e Shoqates per Pajtim Mbarekombetar, duke shtuar se "tradita shqiptare nuk e ka pranuar asnjehere vetëgjyjesine". Dinamika e marrjes se gjakut dhe ngujimi nuk janë me sipas rregullave te Kanunit. Gjithcka ka pesuar nje shnderrim total. Ai eshte kaotik e i pakontrolluar. "Metoda e punes tone" shprehet nje misionar i pajtimeve "eshte qe ose palet te bien ne ujdj duke pranuar zbatimin e ligjit ose te ndjekin traditen (rregullat kanunore).

Por, gjithcka ndjek edhe nje rruge te trete. Konfliktet sociale te pas 90 ne Shqiperi qe erdhen si shkak e grabitjeve, rebbimit te pronave, trafikut te armeve, droges e femrave krijuan nje atmosfere nxitese per vrasjet per hakmarrje e gjakmarrje. Kjo edhe ne zonat te Jugut ku me pare fenomeni ishte inkezistent.

Jane 5000 persona te cilet humben jeten me vetëgjyjesi deri ne vitin 2005. Vetem 7 % e gjakmarrjeve kane per baze konfliktet e hasmerite e vjetra, sipas te dhenave te komitetit te Pajtim, pjesa tjeter janë pasoje e asaj qe ndodhi ne vend pas vitit 1990.

Kanuni parashikon pagesën për ndërmjetësin

Ngujimi eshte elementi i vetem qe i identifikon si gjakmarrje. Prej kohesh brenda ketij realiteti gri, veprojne ne shoqata e misione te pajtim

vetë historia e Komitetit te Pajtim Mbarekombetar. Krijuar ne vitin 1991 iu desh te perballej me disa qindra konflikte e hasmeri gje qe sollën 2300 familje te ngujuara.

Ne vitin 1998, nje drejtues i komitetit, nga Shkodra, largohet per ne Kanada. U fol per kercentime por edhe per abuzime te medha me fondet.

Në 2001 Norvegjia jep financimin e parë

Ne vitin 2001 zhvillohet Kongresi i pare i pasuar nga nje Kongres i jashtezakonshem i cili u organizua ne atmosferen e rende te vrasjes se drejtuesit E.S., po nga Shkodra. Ajo qe u diskutua me fort ishte "thirrja e tradites ne ndihme te jetes", ku me "tradite" nenkuptohet zbatimi i rregullave kanunore. "Pune jone eshte fisnike, por me fondet qe une administroj qe prej 9 vjetesh eshte e veshiture te kesh rezultatet qe kerkon" shprehet Marku. Jane 40.000 USD te dhena ne forme granti nga OKB dhe qeveria Norvegjeze permes ambasadës se saj ne Tirane.

Per tu kthyer edhe nje here ne vitin 2001, cuditerisht u kerkua qe shtypi "te mos perdorte me termin "pajtim gjaqesh pasi kjo nxitë psikologjine e gjakmarrjes". Kjo me argumentin se mediat ashtu sic nxitën gabimisht fenomenin fajde ashtu edhe keqperdoren, glorifikuan e ekzagjeruan me termin gjakmarrje". Ate vit numri i hasmerive arriti ne 1300 duke pesuar rritje gjate dy viteve te metejme 2002-2003. Misionaret e Pajtimit edhe pse pretendojne se kane qene te vetem e pa perkrahje, japin nje pasqyre gjithsesi optimiste te punes se tyre. "Jane rreth 700 familje qe kane deklaruar se do te heqin dore nga gjakmarrja, vetem nese vrasesi merr nje den-

edhe 4500 familje, te prekura nga tenomeni i trafikimit te femrave, te cilat nga misionaret konsiderohen si "kontigjent i ri hasmerie". Per shkaqe pronesie, vetem ne zonen e Nenshkodres e fshatrat e Zadrimes mund te shkojne ne cdo cast drejt konflikteve me pasoje gjakderdhjen rreth 1600 familje. "Ne keto raste puna jone behet edhe me e veshiture" shprehen ne komitetin e Pajtimit Shkoder. Nje pjese e madhe janë familje me lidhje gjaku e kusherinj te grades se pare e te dyte.

Ne shtator te vitit 2004 Komiteti i Pajtimit Mbarekombetar konsideroi si te papershtatshme variantin e projektligjit te paraqitur ne parlament, "Mbi Masat Administrative kunder gjakmarrjes. Vetem tre vjet me pare ne 2001 ne Kodin Penal u bene disa amendime. Sipas nenit 78/2 vrasjet per motive gjakmarrje denohen minimalisht me 20 vjet dhe maksimalisht me burgim te perjetshem. Po ne vitin 2001 komiteti i Pajtimit pat vendosur ne nje takim misionarësh pajtimi "lenien e pergjegjesise se vrasjes se vrasjes mbi autorin e te ndiqej penalisht nga shteti". Ndersa ne Kongresin e 2004 u theksua nevoja per "rikthimin e tradites kanunore per vendosjen e rregullit ne komunitet, ku shteti nuk ka mundur te ushtroje plotesisht autoritetin e tij".

Spekullim me identifikimin e vrasjes

"Mbetet problem i vazhdueshem" shprehen misionare te pajtimit te Mirdites mbetet "spekullimi me identifikimin e vrasjes". Ne ndryshim nga hakmarrja, vrasja per gjakmarrje dallohet nga menyra e ekzekutimit, pregatitja e vendimit dhe sjellja ndaj viktimës. Mjafton te shikosh disa dosje hasmerish, per te vertet-

uasite vendit), pasi ndiqen nga isin i tejuari i vajzes Drane K. Konflikt qe pretendohet se ka filluar ne mesin e vitit 2006. "Per disa arsye, por edhe ato te Kanunit te Leke Dukagjinit, i fejuari i meparshem e Dranes nuk pranoi qe kjo e fundit te marthohet me nje tjetër" shkruhet ne nje gazete lokale. Ajo qe vijon me pas janë prita me arme arrati e serisht prita, gjithmone sipas gazetes.

Nuk mungojne rastet kur djaloshi N.F per "arsye politike, pasi ka mbeshetur kandidatit e parties X, eshte sulmuar nga njezet te panjohur". Rastin ne fjale pershkruhet ne gazete si "nje kercentim jete me prapavije politike e per pasoje N.F. qe nga vjeshta e 2005 eshte i detyruar te braktise vendin". Nje mekanizem ne dukje efikas i cili ka cmimin e tij. Burimi anonim deklarojne per 600 deri 800 euro publikimi ne nje gazete i konflikti, te sajuar, te fryre apo pseudokonflikti. Gjithmone me baze "hasmerite sipas rregullave te kanunit te Lekes".

Te identifikosh e te trajtosh ngjarjet bazuar ne statistika te sakta ndoshta do te ishte detyra e pare e nje shoqate qe merret me fenomenin e gjakmarrjes, por gjithcka pikerisht ketu fillon e veshituresohet.

Ne maj te ketij viti Drejtoria e Policise se Qarkut Kukes jepte vetem per rrethin e Tropojes 10 familje te ngujuara, ne e njeten kohe ne nje gazete lokale shifra e familjeve qe jetojne te ngujuara ne Tropoje arrinte ne 290 familje.

"Kulla e ngujimit, vendi ku fajtori pret qe dikush do te ndermjetoje, qe fajti te gjykohe me drejtesi" thuhet ne nje kartoline sensibilizimi financuar nga qeveria hollandeze. Eshte viti 2008.

Artan BIZHGA
Shkrimi u mundësua nga
IMS(International Media Support) dhe Danish
Association Investigative Reporters (FUJ).